



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Data 27.02.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM I MIRËMBAJTJES SË PAJISJEVE TË MAMOGRAFISË LËVIZËSE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): SHËRBIME TË TJERA

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,509,600 (SHTATËMILION E PESËQIND E NËNTËMIJË E GJASHTËQIND) LEKË PA TVSH dhe shumatorja e çmimeve për njësi për 1 (një) muaj shërbim për dy mamografitë në total është 625,800 (gjashtëqind e njëzet e pesëmije e tetëqind) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Instituti i Shëndetit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, i ndryshuar në të cilën është e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi:Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

Ky kriter i siguron AK që operatori ekonomik nuk ka detyrime ndaj Institucioneve Shtetërore (taksa, tatime, oshe, etj, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në shtojcës 8 të DST) duke e siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatori ekonomik, do ta realizojë kontratën me sukses.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë). (nuk është e aplikueshme)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019 ,2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20%

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti OE duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të kërkuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar , për të cilën ofertohej, konkretisht **7,509,600 *20% =1,501 920 (njemilion e pesëqind e njëmijë e nëntëqind e njëzet) Lek**
Kur konkurohet për vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është kryer brenda kufirit të vlerës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues, nëpërmjet xhiros së realizuar në një nga tre vitet e kërkuara. Është e rëndësishme që ofertuesi, përpara se të dorëzojë ofertën duhet të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin, mundësinë e likuiditeteve të nevojshëm për ekzekutimin e suksesshëm të kontratës.

AK ka parashikuar vlerën jo më të vogël se 20 % , në zbatim të limiteve të vendosura nga VKM-ja nr 285 datë 19.05.2021, në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, dhe ky kriter, është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi **deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohet*Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të (*shëno bazën ligjore*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(*Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor*) **(nuk është e aplikueshme)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____ (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese*). **(nuk është e aplikueshme)**

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **15 % të vlerës së fondit të limit të përlogaritur.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, jo më të vogël se **15 %** do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, për të cilën ofertohej, **konkretisht**

7,509,600 *15% =1,126,440 (një milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e dyzet) Lekë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet vlerën jo më të vogël se 15% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore/polisa sigurimi për ta provuar kryerjen e tyre, qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

AK ka parashikuar një vlerë jo më të vogël se 15 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, duke qenë se objekti i kontratës është specifik, dhe është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të vlefshme, të nevojshme për realizimin e kontratës, konkretisht, si më poshtë vijon:

- a) Operatori ekonomik të jetë i paisur me certifikatë ISO:14001:2015 Sistemi Nderkombetar i Menaxhimit Mjedisor, të vlefshme. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë

- b) Operatori ekonomik të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, të vlefshme. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- c) Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikate BS OHSAS 18001:2007 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë, të vlefshme, ose certifikate ISO 45001:2018. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. *Dokumenti duhet të jetë origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79/1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Argumentimi kësaj kërkesë lidhet ngushtë me objektin e kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e cilësisë se nevojshme dhe operojnë sipas standarteve të cilësisë për të realizuar kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, duke siguruar AK qëkto shërbime do të kryhen sipas standarteve

- d) Ofertuesi duhet të paraqesë licensë të vlefshme për të kryer veprimtarinë import, eksport, instalim dhe mirëmbajtje ose veprimtarinë mirëmbajtje të burimeve të rrezatimit jonizues përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, licensë kjo e lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, në përputhje me ligjin nr. 8025 datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79/1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në përputhje me ligjin 8025 datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar.

Argumentimi kësaj kërkesë lidhet ngushtë me objektin e kontratës. Duke qënë se janë pasije që përdorin burime jonizuese Ak duhet të jetë i sigurt që Operatori fitues është i licencuar për të kryer

këtë lloj aktiviteti, për të kryer importe exopрте , sipas këtij legjislacioni në qoftë se do të jetë e nevojshme shërbimi I ndërrimit të pjesëve të paisjeve objekt I kësaj kontrate, dhe siguron AK që këto shërbime do të kryhen sipas standarteve

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi listën e punonjësve të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
2 (dy)	Inxhinier Elektronik/Elektrik, të nevojshëm për mirëmbajtjen e aparturave të mamografive, ku të paktën njëri prej tyre të ketë trajnimet e nevojshme për mirëmbajtjen e pajisjeve të mamografive, të certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i paisjeve mamografike.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a. Diplomën e personelit, nëse është rasti të njësuar në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), origjinale ose njësi me origjinalin e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit .
- b. CV e personelit
- c. Të paktën një nga stafi të paraqesi Certifikatë Trajnimi të certifikuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar i paisjeve mamografike objekt i kësaj kontrate origjinale ose njësi me origjinalin e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit .

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar.kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***(nuk është e aplikueshme)***

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me specifikimet teknike dhe nevojës për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtje së mamografive lëvizëse të Institutit të Shëndetit Publik.

Është kërkuar numri minimal i punonjësve, nga 1 (një) punonjës për secilën makinë/paisje objekt i kësaj kontrate

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Argumentimi kësaj kërkesë lidhet ngushtë me objektin e kontratës. AK nëpërmjet kësaj kërkesë sigurohet që OE ka stafin e nevojshëm të kualifikuar për të kryer shërbimin objekt të kësaj kontrate në stafin e operatorit ekonomik, të cilët njohin paisjet, dhe kanë njohuritë e duhura për këto paisje dhe të paktën njëri të jetë i trajnuar prodhuesi ose distributor I autorizuar I paisjeve mamografike objekt i kësaj kontrate

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht -- persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

(nuk është e aplikueshme)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

.....
.....

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer). (nuk është e aplikueshme)

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

.....
.....

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

.....
.....
.....
(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:). *(nuk është e aplikueshme)*

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.2. Nje deklaratë që merr përsipër zëvendësimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit, për pajisjet mamografive, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për të garantuar Autoritetin Kontraktor se pjesët e konsumit që do duhet të përdoren për pajisjet e mamografive do të jenë të reja, origjinale dhe në përputhje me ato që do të zëvendësohen, për të krijuar mbrojtje për këto pajisje, mirëfunksionimin e tyre, dhe për të vazhduar pa ndërpreje punën e mamografive.

Argumentim, kjo siguron AK që OE do të jetë gatshëm të zëvendësojë pjesët e këmbimit të nevojshme , kur të paraqitet rasti dhe të sigurojë cilësinë dhe garancinë e tyre me qëllim një shërbim të sigurt dhe cilësor

2.4.3. Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve, periodicitein e tyre dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë venoset me qëllim për të garantuar Autoritetin Kontraktor se kryerja e shërbimit për mirëmbajtjen e mamografive do të kryhet

sipas nevojave të Autoriteti Kontraktor, duke marrë parasysh faktin se këto pajisje janë gjatë të gjithë kohës në lëvizje dhe është e rëndësishme që të jenë në gjendje punë të pa ndërprerë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Kjo fjali është marrë identike si shfaqet edhe në modelet e “Dokumentet Standarde të Tenderit”, që gjenden në faqen e APP-së, për procedurat e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”)

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë përcaktuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:

Shërbimi që duhet të ofrohet: ***Mirëmbajtja full risk e paisjeve të Mamografive lëvizëse të inkorporuara në makina si më poshtë:***

Nr.	Përshkrimi	Prodhuesi /modeli	Sasia
1	Mirëmbajtje e paisjeve të Mamografive të inkorporuar në makina.	Mamografi të tipit Helianthus, prodhuar nga Metaltronica	2

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve të mamografisë dhe pjesëve përbërëse të saj, për të ruajtur sistemin e pajisjeve në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjes. Për të kryer mirëmbajtjet parandaluese. Operatori ekonomik duhet të mbajë nën kontroll temperaturën e kushteve të makinës.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, në identifikimin e shkaqeve, në eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, në verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin e mamografisë.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së paisjes, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontroleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendur në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime, përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Te gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rrezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjet përkatëse;
- Gjeneratori;
- Dedektori;
- Paneli i kontrollit;
- Borde, konektorë, qarqe dhe elementë elektronikë;
- Komponente hardëare, softëare
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve;
- Pajisja UPS e pajisjeve, bateritë;
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes;
- Pjesë të tjera elektrike, e materiale të tjera që i përkasin vendit ku kryehet mamografia.

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimin.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve

Personeli teknik i të Kontraktuarit do të garantojnë mbulimin e shërbimit për një periudhë 12 mujore me lidhjen e kontrates , me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:30 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda ditës së punës kur makina me mamografinë lëvizëse do të jetë në Tiranë dhe në distancat deri në 100 km, ndërsa 2 dite pune kur makina me mamografite lëvizëse do të jetë më larg se 100 km.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 10-15 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Argumentimi : Përcaktimi specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, janw, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

Mirëmbajtje full risk e paisjeve të MAMOGRAFIVE LËVIZËSE TE INSTALUAR NE MAKINA.
(Mamography Unit me X-Ray tube dhe Direct Conversion Amorphous Selenium detector 24x30 cm format me jo Isocentric (HELIANTHUS).

Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Modeli	Sasia	Afati
1	Mirëmbajtje e paisjes së Mamografisë e inkorporuar në makinë. Mjeti me targe AA157KM	Mamografite tip Helianthus, prodhuar nga Metaltronica	1	Me lidhjen e kontratës një periudhë 12 muje
2	Mirëmbajtje e pasjes së Mamografisë e inkorporuar në makinë. Mjeti me targe AA158KM	Mamografite tip Helianthus, prodhuar nga Metaltronica	1	Me lidhjen e kontratës për një periudhë 12 mujore

Afatet e ekzekutimit: Afati i ekzekutimit për objektin “Shërbim i mirëmbajtjes së pajisjeve të mamografisë lëvizëse”, do të jetë 12 muaj duke filluar nga momenti i nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër me Operatorin Ekonomik të Suksesshëm.

Shërbimet	Përshkrimi	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim i mirëmbajtjes së mamografive lëvizëse	Mirëmbajtje e paisjes së Mamografisë e inkorporuar në makinë. Mjeti me targe AA157KM	Pranë makinave lëvizëse ku janë të instaluar paisjet e mamografisë (ne zbatim tëspecifikimeve teknike)	Me lidhjen e kontratës për një periudhë 12 mujore
Shërbim i mirëmbajtjes së mamografive lëvizëse	Mirëmbajtje e pasjes së Mamografisë e inkorporuar në makinë. Mjeti me targe AA158KM	Pranë makinave lëvizëse ku janë të instaluar paisjet e mamografisë (ne zbatim tëspecifikimeve teknike)	Me lidhjen e kontratës për një periudhë 12 mujore

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, e cila ndihmon AK për të siguruar në kohë shërbimin dhe sasinë e kërkuar nga OE, si dhe i jep mundësinë OE të planifikojë ofertën mbi bazën e kërkesave të AK

Shtojca 7 ((Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mirëmbajtja e paisjeve të mamografisë lëvizëse të inkorporuara në makinat e ISHP-së, Fiat IVECO, të përshkruara në Shtojcën 6. **Shërbimi i mirëmbajtjes do të jetë full risk** për të gjithë defektet që do të ndodhin në pajisjet e mamografisë.

Aparaturat e mamografisë të tipit Helianthus të kompanisë prodhuese Metaltronica s.p.a(Mamography Unit me X-Ray tube dhe Direct Conversion Amorphous Selenium detector 24x30cm format me jo Isocentric) dhe janë të montuara në makina.

Detyrat: Operatori Ekonomik duhet të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes për të siguruar të dhëna sa më të sakta dhe që mamografitë të jenë në gjendje pune gjatë të gjithë vitit, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcën 5.

Shpërndarja: Mirëmbajtja do të kryhet në çdo ambient ku ndodhen pajisjet e mamografive, në Institutin e Shëndetit Publik ose në rrethe, nese do të ndodh defekti (në qoftëse nuk është e mundur që makina të silllet në qytetin e Tiranës).

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **Pranë makinave lëvizëse ku janë të instaluar paisjet e mamografisë dhe Instituti i Shëndetit Publik.**

Argumentimi: Termat e Referencës janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, e cila ndihmon AK për të siguruar në kohë shërbimin dhe sasinë e kërkuar nga OE, si dhe i jep mundësinë OE të planifikojë ofertën mbi bazën e kërkesave të AK

* * *

Për sa më sipër, anëtarët e Njesisë së Prokurimit miratojnë nëpërmjet këtij procesverbali kriteret e mësipërme të kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë. Njësia e Prokurimit do t'i pasqyrojë ato në Dokumentet Standarde të Tenderit të kësaj procedure, dhe së bashku me DST, procesverbali do të ngarkohet në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Personi i autorizuar i Njesisë së Prokurimit për kryerjen e veprimeve në SPE caktohet Lindita Kokona e cila do të vijojë me dërgimin e dokumenteve të tenderit për publikim dhe hedhjen në sistem të dokumentacionit që kërkohet.

* * *

Pasi lexohet, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. Lindita Kokona

(emri, mbiemri, firma)

2. Alban Ylli

(emri, mbiemri, firma)

3. Aldo Qejvani

(emri, mbiemri, firma)